

HAPËSIRA MONETARE OPTIMALE: UNIONI MONETAR EVROPIAN

*Dr. Fadil Govori, prof. ass.⁴⁹
govorif@gmail.com*

Abstrakti

Përdorimi i monedhës së përbashkët mbart kosto të caktuara. Teoria e hapësirës monetare optimale balancon dobësitë dhe kostot e përdorimit të monedhës së përbashkët. Nëse çmimet dhe pagat janë fleksible, kursi i këmbimit ndihmon në zgjidhjen e situatave kur paraqiten tronditje asimetrike. Në unionin monetar janë me rëndësi tronditjet asimetrike të vendeve anëtare. Teoria e hapësirës monetare optimale shtron çështjen se cilat karakteristika të unionit monetar ndikojnë në paraqitjen e tronditjeve asimetrike. Ajo më pas zhvillon parimet, të cilat nëse përmbushen, i bëjnë humbjet nga kursi i këmbimit më pak të dhimbshme. Tri parime ekonomike klasike të teorisë së hapësirës monetare optimale janë: Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore; Shumëllojshmëria e prodhimit; dhe Hapja e ekonomisë kombëtare. Tri parime politike të teorisë së hapësirës monetare optimale janë: Transferët fiskal; Homogjeniteti i preferencave; dhe Solidariteti mes vendeve anëtare të unionit monetar.

Fjalët kyçe: Hapësira monetare, unioni monetar, monedha e përbashkët, informacioni asimetrik.

JEL klasifikimi: E, E0, E5, E6, G, G0, G1.G2

Hyrje

Në këtë punim do trajtojmë çështjen e hapësirës monetare optimale. Punimi paraqet elementet kryesore të teorisë së hapësirës monetare optimale, nxjerrë në pah dobësitë dhe kufizimet kryesore të tyre, dhe paraqet konturat e disa kriterëve tejkombëtare të teorisë së hapësirës monetare optimale.

Në fillim do të parashtrojmë çështjen dhe problemin e hapësirës monetare optimale, dhe do provojmë të gjejmë përgjigjen për ato. Si pikënisje për trajtimin e kësaj çështje me rëndësi të madhe makro-ekonomike duhet të përdoren arritjet në fushën teorike, teoria e hapësirës monetare optimale dhe parimet themelore mbi të cilat mbështetet ajo. Mbi bazë të trajtimeve teorike, ne mund të shtrojmë pyetjen fundamentale: Cilat vende synojnë dhe do mund të përfitojnë nga përdorimi i monedhës së përbashkët? Teoria e hapësirës monetare optimale nuk ofron përgjigje të gatshme bardhë e zi, ajo më tepër merret me zhvillimin e parimeve për vlerësimin

⁴⁹ Autori është pedagog i grup lëndëve në FSHAB Pejë

e kostove dhe dobive të formimit të unioneve monetare. Duke i zbatuar ato parime në Bashkimin Evropian, ne zbulojmë se disa nga ato parime janë përmbushur, por jo edhe disa të tjera. Ky konkluzion ilustron debatet e pafund mbi meritat e Unionit Monetar Evropian. Ai gjithashtu përbën një paralajmërim se ku mund të paraqiten probleme, dhe sugjeron përgjigje se si do mund të zgjidhen ato.

Gati 50 vite kan kaluar që nga themelimi i teorisë së hapësirës monetare optimale (the optimum currency area theory - OCA), duke iu falenderuar kontributit që dhanë me punimet e tyre, Mundell (1961), McKinnon (1963) dhe Kenen (1969). Këto punime sugjerojnë disa parime që përcaktojnë një hapësirë monetare optimale, e që duhet të përmbushin vendet që synojnë të themelojnë një union monetar. Këto parime përfshijnë simetrinë e tronditjeve themelore makro-ekonomike, mobilizimin e faktorëve të prodhimit, hapjen e ekonomisë kombëtare, skemat e rishpërndarjes fiskale, dhe fleksibilitetin e pagave reale. Të gjitha ato kritere edhe më tutje janë në epiqendër të debateve mbi integrimet monetare.

Në kohën më të re, disa autor theksojnë domosdon e krijimit të një organi qeveritar mbi-kombëtar (supra-national government body), që do të administrojë transferët ndër-regjional (De Grauwe, 1997). Frankel dhe Rose (1997, dhe 1998), Corsetti dhe Pesenti (2002), dhe De Grauwe dhe Mongelli (2005), ekzaminojnë karakteristikat e hapësirave monetare optimale. Zbulimet e këtyre autorëve tregojnë se unionet monetare shpiejnë kah rritja e integriteteve tregtare. Për shembull, Frankel dhe Rose (1997 dhe 1998) argumentojnë se edhe nëse një vend nuk i përmbush kriteret fillestare për bashkim në një union monetar, rritja e tregtisë brenda unionit monetar si rezultat i përodrimit të monedhës së përbashkët, mund të kualifikojë këtë vend që të përmbush kriteret për anëtarësim në unionin monetar.

Në muajin Maj 2008, ishin bërë dhjetë vite nga vendimi për të lëvizur drejtë fazës së tretë dhe përfundimtare të Unionit Monetar Evropian (The European Monetary Union - EMU), dhe vendimit se cilat do ishin vendet e para që do të përdornin njësinë e përbashkët monetare euro. Tani dhjetë vjetë pas, Komisioni Evropian ka ndërmarr një rishikim strategjik të Unionit Monetar Evropian. Në trajtimet tona do të mbështetemi edhe në kërkimet që ishin drejtuar apo ishin financuar nga Komisioni Evropian, dhe ishin publikuar në vitin 2008.

Në faktë, pyetja kryesore që shtrohet sa herë që diskutohet për unione monetare optimale është se, sa është e arsyeshme dhe sa ka kuptim që një grup i vendeve të heqë dorë nga monedhat e tyre kombëtare. Pra, pyetja reale që shtrohet në ato raste është: Sipas cilave kushte një hap i tillë do ishte me më pak dhimbje? Teoria zhvillon një sërë parimesh ekonomike dhe politike të cilat pranojnë/arsyetojnë se kosto ekonomike reale e heqjes dorë nga instrumenti i kursit të këmbimit valutor del nga prezenca e tronditjeve asimetrike, tronditje këto që nuk ndikojnë të gjitha vendet anëtare të unionit monetar. Mbi këtë bazë ne do analizojmë nëse Unioni Monetar Evropian ka kaluar me sukses këto teste, dhe do vijmë te konkludimi se ai nuk përbën një union monetar optimal, por edhe që nuk ka dështuar plotësisht. Po ashtu, duhet kuptuar qartë se karakteristikat kombëtare nuk janë të ngrira dhe se, me kohë, nga se ka adoptuar monedhën e përbashkët, Evropa do mund të përmbush të gjitha apo pothuaj të gjitha parimet.

Punimi është organizuar në shtatë sekcione, ku sekcioni i parë përbën një vështrim të përgjithshëm hyrës, pesë sekcionet vijuese zhvillojnë temën kryesore, më pas në pjesën e shtatë pasojnë konkluzionet, dhe në fund jepen referencat bibliografike. Sekcioni 1 merret me çështjen e hapësirës monetare optimale, me përkufizimin e problemit, dhe kërkimin e përgjigjeve të mundëshme. Në sekcionin 2 trajtojmë teorinë e hapësirës monetare optimale, që nga burimi i saj Mundell (1961), McKinnon (1963) dhe Kenen (1969), dhe paraqesim qasjet e kohës më të re të kësaj teorie. Në sekcionin që pason, 3, trajtojmë parimet e teorisë së hapësirës monetare optimale, duke i ndarë ato në parimet ekonomike dhe parimet politike. Në sekcionin katër do të provojmë të gjejmë përgjigje në pyetjen nëse Bashkimi Evropian përbën një hapësirë monetare optimale, duke krahasuar rezultatet e arritura me parimet themelore teorike që kemi trajtuar në sekcionin e mëparshëm. Nga konstatimet e nxjerra në këtë sekcion do vazhdojmë trajtimet në sekcionin e pestë duke kërkuar përgjigje në pyetjen tjetër, nëse Bashkimi Evropian do bëhet një hapësirë monetare optimale në të ardhmën?


1. Çështja, problemi, përgjigja: Përkufizimi

Për një kohë të gjatë ishte bërë si rregull që secili vend të zotërojë monedhën e vet. Simbolet kombëtare ekspozohen në monedha dhe kartëmonedha po thuaj njëjtë sikurse lordët feudal që shtypnin fytyrat e tyre në monedhat prej ari dhe argjendi. Këtë rregull e karakterizonin disa pritshmëri, shumë prej të cilave ishin më pak reale e më tepër ekzotike. Veçse krenari, shtrohet pyetja nëse kjo lidhje midis kombit dhe monedhës është e arsyeshme nga aspekti ekonomik? Nëse neglizhojmë aspektin kombëtar dhe fokusohemi thjesht në marrëdhëniet ekonomike, si do të dukej harta e re e botës? Kjo përbën pyetjen që do provojmë të eksplorojmë në këtë punim.

Për fillim bëhet pyetja nëse bota ka nevojë për më tepër se një monedhë? A mund të përdorin një monedhë të përbashkët Zimbabve, Peru, dhe Kina? Është shumë e mundshme që jo. Ekstremit tjetër do ishte, nëse secili qytet do duhej të kishte monedhën e vet, siç ishte praktikë disa shekuj më parë? Sigurisht që jo. Këto përgjigje duken të qarta, por pikërisht pse?

Paraja është e dobishme sepse ajo i lehtëson transaksionet tregtare dhe financiare, të cilat do të paraqiteshin më të vështira si shkëmbim trambë, dhe sepse paraja është e pranuar menjëherë. Sa më tepër që e pranojnë njerëzit atë, aqë me e dobishme bëhet paraja. Në këtë kuptim, bota do përfitonte nga zotërimi i vetëm një monedhe, që do pranohej gjithandej dhe do mundësonte tregtinë globale të zhvillohet pa u ngarkuar me transaksione me kosto të larta. Kjo tregon pse hapësirat e vogëla monetare – zonat gjeografike që përdorin monedhën e përbashkët – nuk përbëjnë hapësira monetare optimale të mirëfillta. Kjo pjesë e përgjigjes është plotësisht e saktë. Ekzistojnë dobi dhe kosto në lidhje me adoptimin e monedhës së përbashkët. Ndërsa, zgjidhja e këtij problemi përfshinë tregtimin e atyre dobive. Kjo

do të thotë se dobia e parasë rritet me rritjen e hapësirës në të cilën ajo përdoret⁵⁰. Ky konstatim është ilustruar në Figurën 1.



Mirëpo, sa më tepër rritet hapësira monetare, ajo bëhet me e shumëllojshme dhe, kjo sjellë kosto shtesë, të cilat madje mund të rriten konsiderueshëm me rritjen e hapësirës monetare. Kjo ide është ilustruar në Figurën 1, përmes lakorës në rënie të dobisë marginale. Diveristeti i hapësirës monetare shprehet në shumë forma – disa janë ekonomike, e disa të tjera janë politike. Aspektet ekonomike ndërlihen me faktin se monedha e përbashkët shtron domosdon e një banke qendrore, e cila është e paaftë të ndikojë në disa kushte të veçanta lokale. Deri sa ato kushte janë homogjene, kjo nuk përbën ndonjë problem. Tronditjet asimetrike, ato që ndikojnë disa vende apo regjione brenda hapësirës monetare, e jo disa të tjera, apo të cilat krijojnë efekte të ndryshme në vende të ndryshme, rrisin kostot e përdorimit të monedhës së përbashkët.

Teoria e hapësirës monetare optimale synon të identifikojë në mënyrë të saktë raportet që sugjeron Figura 1. Kjo teori supozon se kufiri optimal i hapësirës monetare korrespondon me gjendjen kur arrihet bilanci midis kostove dhe dobive nga përdorimi i monedhës së përbashkët, siç është paraqitur në Figurën 1. Më vonë do shohim se kjo figurë është vetëm simbolike, sepse siç do kuptojmë, nuk është e mundur të paraqiten në mënyrë ekzakte të gjitha ato efekte.

⁵⁰ Teoria është zhvilluar nga Dawid, K. and D. Greenaway (1993) 'Currency competition, network externalities and switching costs: Towards an alternative view of optimum currency areas', *Economic Journal*, 103 (420), 1180-89.

2. Tronditjet asimetrike dhe efektet e tyre: Si funksionojnë ato


Supozojmë se kërkesa botërore për eksportet e vendit përkatës bie, sepse kanë ndryshuar shijet, apo sepse janë zhvilluar mallra alternative në vendet e tjera. Kjo krijon probleme në balancin tregtar. Për të ri-vënë balancin në tregtinë e jashtme, vendi përkatës duhet të bëjë më të lira eksportet e saj. Kjo kërkon rritjen e konkurrencës. Në rastin kur vendi zotëron monedhën e vet kombëtare, kjo zakonisht arrihet përmes zhvlerësimit të monedhës kombëtare (depreciation). Por, kur vendi nuk zotëron monedhën e vet kombëtare, pra kur vendi është pjesë e hapësirës më të gjerë monetare, ai duhet të gjejë mënyra të tjera për të ulur çmimet e mallrave që eksporton, e kjo kërkon kosto më të ulëta prodhuese dhe paga më të ulëta.

Kjo situatë është paraqitur në Figurën 2, e cila ilustron kërkesën dhe ofertën për mallrat vendore, sipas kursit real të këmbimit (kursit real valutor), që definohet si çmimi relativ vendor ndaj mallrave të jashtme⁵¹. Oferta e mallrave vendore rritet krahas rritjes së kursit real, sepse kjo ndikon në rritjen e profitabilitetit në vend kur disa kosto të prodhimit ndërlidhen me çmimet e jashtme (për shembull, me makineritë e importuara, me mallrat gjysmë-finale, me naftën, etj.). Kërkesa bie kur kursi real i këmbimit rritet për arsye të njohura që shtyejnë konsumatorët në vend dhe ata jashtë vendi të zhvendosen kah mallrat e jashtme më të lira.

Tronditjet asimetrike në kërkesë janë paraqitur në Figurën 2, si rënie e kërkesës botërore për mallrat vendore (shmangie në të majtë) nga D në D' . Nëse është i lejuar zhvlerësimi i monedhës kombëtare, apo nëse çmimet dhe pagat janë fleksibël, efekti do jetë lëkundja nga pika A në pikën B : rezultati zvogëlohet dhe kursi real i këmbimit bie nga λ_0 në λ_1 . Kjo me siguri se është një lëvizje e dhimbëshme, por është e pashmangëshme si rezultat i tronditjes asimetrike.

Lëvizja do ishte edhe më e dhimbëshme nëse kursi i këmbimit do ishte fiks dhe nëse pagat do ishin fiks. Në atë rast rezultati është paraqitur me C , ku rënia është edhe më e madhe. Shembulli poashtu ilustron dhe pse kursi fiks i këmbimit, i kombinuar me çmime dhe paga fiks, krijojnë situatë shumë më të rëndë. Si konstatim i përgjithshëm nga kjo del se unioni monetar rregullon ndryshimet e kursit nominal të këmbimit brenda hapësirës monetare, dhe se, edhe kursi real i këmbimit i vendit të ndikuar duhet të rregullohet. Në vend që përmes rregullimit një herë e përgjithmonë të kursit nominal të këmbimit, rregullimi i kursit real të këmbimit duhet të bëhet përmes ndryshimeve në çmime dhe paga. Nëse çmimet dhe pagat janë fleksibël, rregullimi kërkon kohë të caktuar, duke krijuar vështirësi dhe varfëri.

⁵¹ ($\lambda = EP/P$), λ është kursi real i këmbimit, EP është kursi nominal i këmbimit, dhe P është çmimi i mallrave në vend.

Figura 2 Një tronditje asimetrike në kërkesë


2.1. Problemet që paraqiten nga prezenca e tronditjeve asimetrike në hapësirën monetare

Në trajtimet e gjërtanishme kemi vështruar vetëm një vend të izoluar. Tani do vështrojmë dy vende, vendin A, dhe vendin B, që formojnë një hapësirë monetare. Vendi A zbaton dy kurse të këmbimi (nominal dhe real): njërin e përdor përballë vendit B, dhe tjetërin e përdor përballë pjesës tjetër të botës. E njëjta vlen edhe për vendin B.

Nëse vendi A dhe vendi B goditën nga tronditje asimetrike, ato të dyja duhet të zbatojnë zhvlerësimin e kursit të këmbimit të valutës së tyre të përbashkët, përballë pjesës tjetër të botës, ndërsa sipas vlerësimit të përafërtë, nuk ka nevojë për ndryshimin e kursit të këmbimit (nominal dhe real) përballë njëra tjetrës. Kjo sepse, ato të dyja janë në anijën e njëjtë që po përballet me erën. Mirëpo, situata do jetë e ndryshme, nëse vetëm vendi A është goditur nga një tronditje asimetrike. Vendi A tani duhet të zbatojë dy zhvlerësime të kursit të këmbimit, përballë vendit B, dhe përballë pjesës tjetër të botës.

Kjo tregon se zhvlerësimi i kursit të këmbimit brenda unionit monetar nuk krijon pasoja sa kohë që të gjitha vendet anëtare përballën me tronditje të njëjta. Në rastin kur unioni monetar goditet nga tronditje asimetrike, unioni vetëm e rregullon kursin e përbashkët të këmbimit përballë pjesës tjetër të botës, ndërsa vendet anëtare duhet të rregullojnë kurset e tyre të këmbimit në mënyrë të pavarurë.

Figura 3 Një tronditje asimetrike në Unionin Monetar



Kur ekzistojnë tronditje asimetrike, anëtarësia në union monetar përbënë një faktor kufizues. Çka ndodh atëherë? Kjo pyetje është ekzaminuar në Figurën 3, e cila ilustron unionin monetar të përbërë nga dy vende anëtare. Boshti vertikal tregon kursin real të këmbimit të secilit vend përballë pjesës tjetër të botës: EPA / P^* dhe EPB / P^* , ku PA dhe PB janë çmimet e mallrave vendore në vendin A dhe në vendin B, P^* është niveli i çmimit në pjesën tjetër të botës, dhe E është kursi i përbashkët i këmbimit, fillimisht i barabart me λ_0 që supozohet të jetë i njëjtë në të dy vendet: $\lambda_0 = EoPA / P^* = EoPB / P^*$. Supozohet që çmimet të jenë fleksibël – përndryshe, regjimi i kursit të këmbimit nuk do kishte ndikim fare.

Tani supozojmë se një tronditje asimetrike godet vetëm vendin A. Kjo është paraqitur në panelin e majt të Figurës 3, i cili përshkruan vendin A, kur kërkesa lëviz nga D në D' . Në qoftë se vendi A nuk është pjesë e unionit monetar dhe mund të ndryshoi kursin e këmbimit sipas dëshirës, ai do të lejoi që kursi të zhvlerësohet në vlerën $E1$, ashtu që kursi real i këmbimit të zhvlerësohet në $\lambda_1 = E1PA / P^*$, që mundëson një ekuilibër të ri në pikën B. Vendi B nuk ka nevojë të ndryshoi kursin e këmbimit nominal dhe real, Eo dhe λ_0 . Brenda unionit monetar, gjërat zhvillohen ndryshe. Nëse banka e përbashkët qendrore kujdeset për vendin A dhe e zhvlerëson kursin e përbashkët të këmbimit në $E1$, me çmime fleksibël të dy vendet përdorin kursin e përbashkët të këmbimit λ_1 . Figura 3 tregon se kjo nuk është mirë për vendin B, e cila në këtë rast do përballë me kërkesë të tepërt inflatore (në figurë të paraqitur me distancën $B'B''$). Kjo tregon qartë se në rastin e paraqitjes së një tronditje asimetrike, çka i përshtatet një vendi, e dëmton vendin tjetër. Kjo është kosto fundamentale e krijimit të unionit monetar.

2.2. Tronditjet asimetrike dhe efektet asimetrike

Analiza është fokusuar në tronditjet asimetrike, por kjo mund të zbatohet edhe tek rasti i tronditjeve asimetrike që prodhojnë efekte asimetrike. Ekzistojnë shumë arsye pse dy vende nuk reagojnë në mënyrë të njëjtë ndaj tronditjeve të njëjta asimetrike. Kjo ndodh për shkak të strukturave të tyre të ndryshme socio-ekonomike, duke përfshirë edhe rregulloret dhe traditat e tregut të punës, rëndësinë relative të sektorëve industrial, rolin e sektorëve financiar dhe bankar, borgjit të jashtëm të vendit përkatës, mundësisë për arritje të marrëveshjeve midis firmave, sindikatave, dhe qeverisë, e të tjera. Një shembull i mirë është rritja e papritur e çmimit të naftës dhe gazit natyror. Kjo tronditje asimetrike dëmton vendet që importojnë naftë dhe gaz, por u sjell dobi vendeve eksportuese të naftës dhe gazit, siç janë Holanda, Norvegjia, dhe Mbretëria e Bashkuar⁵².

Asimetria tjetër i përket mënyrë së veprimit të politikës monetare. Kur banka qendrore e përbashkët reagon ndaj tronditjeve asimetrike, kjo nuk do të nënkupton se efektet e veprimit të saj do të jenë të njëjta nëpër të gjitha vendet e unionit monetar. Dallimet ndërmjet strukturave bankare dhe tregjeve financiare, apo dallimet në madhësinë e firmave – dhe aftësisë së tyre për të marrë hua – mund të rezultojnë me efekte asimetrike.

Kur këto efekte janë të ndryshme, analiza e tronditjeve asimetrike nga seksioni i mëparshëm mund të zbatohet në tërësi. Në veçanti, efektet e tronditjeve asimetrike mund të vështrohen si në Figurën 3.

3. Teoria e hapësirës monetare optimale

Hapësira monetare optimale mund të definohet si një hapësirë optimale gjeografike që përdorë një monedhë të përbashkët, apo më shumë monedha të ndërlidhura mes vete. Monedha e vetme, apo monedhat e ndërlidhura, luahten së bashku, përballë monedhave të vendeve të tjera jashtë unionit monetar. Kufijtë e hapësirës monetare optimale përcaktohen nga vendet sovraane që anëtarësohen në unionin monetar. Optimaliteti i hapësirës monetare përcaktohet mbi bazë të kriterëve të caktuara që duhet të përmbush hapësira monetare, siç janë fleksibiliteti i çmimeve dhe pagave, integritet financiar, e të tjera. Më pas trajtohen edhe disa kriterë tej-kombëtare, duke vështuar ngjashmëritë e tronditjeve asimetrike dhe mekanizmat për transimion monetar. Përdorimi i përbashkët i këtyre kriterëve shtron nevojën e rregullimeve të kursit nominal të këmbimit brenda hapësirës monetare duke zvogëluar ndikimin e disa llojeve të tronditjeve asimetrike apo duke lehtësuar rregullimin e tyre më pas. Vendet që formojnë hapësirat monetare zakonisht presin që përfitimet të tejkalojnë kostot, dhe të krijojnë mundësi më të mira për zhvillim të përgjithshëm ekonomik.

4. Parimet e teorisë së hapësirës monetare optimale

⁵² Kjo është një prej arsyeve pse Norvegjia dhe Mbretëria e Bashkuar nuk i janë bashkuar Unionit Monetar Evropian.

Janë të njohura tri parime ekonomike dhe tri parime politike që përcaktojnë optimalitetin e hapësirës monetare. Parimi i parë ekonomik kërkon mënyra për të zvogëluar kostot e tronditjeve asimetrike brenda hapësirës monetare. Dy parimet tjera ekonomike synojnë të identifikojnë se cilat fusha ekonomike nuk do të goditen nga tronditje asimetrike, apo edhe nëse goditen, ato do të jenë tronditje më të buta. Tri parimet e tjera, janë politike, dhe ato pyesin nëse vendet e ndryshme janë në pajtim të ndihmojnë njëri tjetrin në rast të përballjes me tronditje asimetrike.

4.1. Parimet ekonomike që përcaktojnë hapësirën monetare optimale

1. **Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore** (Parimi Mundell): Hapësira monetare optimale janë ato brenda të cilave ekziston lëvizja e lirë e njerëzve dhe e fuqisë punëtore.
2. **Shumëllojshmëria e prodhimit** (Parimi Kenen): Vendet me prodhime dhe eksporte të shumëllojshme (të diversifikuara), dhe me strukturë ekonomike të ngjashme, mund të formojnë një hapësirë monetare optimale.
3. **Hapja e ekonomisë kombëtare** (Parimi McKinnon): Vendet të cilat janë shumë të hapura ndaj tregjeve, dhe tregtojnë kryesisht njëri me tjetrin, mund të krijojnë një hapësirë monetare.

4.2. Parimet politike që përcaktojnë hapësirën monetare optimale

1. **Transferët fiskal** (Parimi i transferit fiskal): Vendet që bien dakord të kompenzojnë njëri tjetrin në rast të tronditjeve asimetrike, formojnë një hapësirë monetare optimale.
2. **Preferenca homogjene** (Parimi i homogjenitetit të preferencave): Vendet anëtare të unionit monetar duhet të arrijnë konsensus në shkallë të gjerë mbi mënyrën e trajtimit të tronditjeve asimetrike.
3. **Solidariteti mes vendeve anëtare të unionit monetar** (Parimi i solidaritetit): Kur politika e përbashkët monetare krijon konflikte të interesave kombëtare, atëherë vendet që formojnë unionin monetar duhet të pranojnë kostot në emër të fatit të përbashkët.

Të gjitha këto parime edhe më tutje janë në epiqendër të debateve mbi integritet monetare.

Në kohën më të re, disa autor theksojnë domosdon e krijimit të një organi qeveritar mbi-kombëtar (supra-national government body), që do të administrojë transferët ndër-regjional (De Grauwe, 1997). Frankel dhe Rose (1997, dhe 1998), Corsetti dhe Pesenti (2002), dhe De Grauwe dhe Mongelli (2005), ekzaminojnë karakteristikat e hapësirave monetare optimale. Zbulimet e këtyre autorëve tregojnë se unionet monetare shpiejnë kah rritja e integriteteve tregtare. Për shembull, Frankel dhe Rose (1997 dhe 1998) argumentojnë se edhe nëse një vend nuk i përmbush kriteret fillestare për bashkim në një union monetar, rritja e tregtisë brenda unionit monetar si rezultat i përodrimit të monedhës së përbashkët, mund të kualifikojë këtë vend që të përmbush kriteret për anëtarësim në unionin monetar.

5. A përbën Evropa një hapësirë monetare optimale?

Në parim, teoria e hapësirës monetare optimale do na tregoi nëse ishte i arsyeshëm krijimi i Unionit Monetar Evropian. Siç kemi përmendur më herët, përgjigja nuk mund të jetë bardhë e zi. Dobitë nga krijimi i unionit monetar është vështirë të kuantifikohen në mënyrë të saktë, sepse secili nga gjashtë parimet e përmendura më sipër mund të jetë përmbushur vetëm pjesërisht.

Pjesa më e madhe e vendeve të Unionit Monetar Evropian përmbushin dy nga tri parimet ekonomike që përcaktojnë një hapësirë monetare optimale. Ato përmbushin parimin e hapjes së ekonomisë kombëtare ndaj tregjeve ndërkombëtare, dhe parimin e shumëllojshmërisë/diversifikimit të prodhimit. Mirëpo, të gjitha ato kanë dështuar të përmbushin parimin e lëvizjes së lirë të fuqisë punëtore. Po ashtu, Evropa ka dështuar të përmbush parimin e transferëve fiskal (parim politik), ndërsa nuk është plotësisht e qartë përmbushja e dy kritereve të tjera politike (Parimi i homogjenitetit të preferencave, dhe Parimi i solidaritetit). Tabela 1 në mënyrë të përmbledhur ilustron shkallën e përmbushjes së parimeve ekonomike dhe politike të hapësirës monetare optimale, tani të zbatuara në Unionin Monetar Evropian.

Tabela 1 Performansa e Unionit Monetar Evropian	
Parimi	Përmbushja
Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore	Jo
Shumëllojshmëria e prodhimit	Po
Hapja e ekonomisë kombëtare	Po
Transferët fiskal	Jo
Homogjeniteti i preferencave	Me gjasë
Solidariteti mes vendeve anëtare të unionit monetar	?

Fillimisht Tabela 1 shpjegon se pse ishte aqë i diskutueshëm projekti i monedhës së përbashkët në Bashkimin Evropian. As përkrahësit e as oponentët e këtij projekti nuk kishin arritur të parashtronin argumente plotësisht të pranueshme. Madje, edhe me zbatimin e parimeve të teorisë së hapësirës monetare dhe krahasimin me arritjet brenda Unionit Monetar Evropian nuk mund të jepen vlerësime përfundimtare plotësisht të sakta. Kjo sepse, as dobitë e as kostot e krijimit të unionit monetar nuk mund të kuantifikohen në mënyrë të saktë, e as parimet e teorisë së hapësirës

monetare optimale nuk përmbushën në tërësi. Prandaj, nga aspekti ekonomik, ky rast mbetet i papërcaktuar, kurse vendimi për të krijuar një union monetar duhet të mbështetet më tepër në vlerësimet politike.

Së dyti, përmbushja e pjesërishme e parimeve të teorisë së hapësirës monetare optimale, lë të kuptohet se, me që vendimi për të zbatuar unionin monetar ishte marr, kjo do krijojë kostot të konsiderueshme për vendet anëtare. Teoria e hapësirës monetare optimale i identifikon ato kosto dhe sugjeron dy konkluzione kryesore: kostot kryesisht do të paraqiten në tregjet e punës, dhe se transferët fiskal duhet të rivlerësohen.

6. A do të bëhet Evropa një hapësirë monetare optimale?

Karakteristikat e Unionit Monetar Evropian nuk janë statike. Niveli i përmbushjes së parimeve të teorisë së hapësirës monetare optimale kryesisht reflekton aspektin historik, ndërsa fakti se UME tani më ekziston, mund të ndryshojë gjërat dhe situatën në përgjithësi. Kjo sepse, ekzistojnë arsye për të besuar se niveli i përmbushjes së parimeve të teorisë së hapësirës monetare optimale është me karakter endogjen që do të thotë se, duke qenë brenda unionit monetar e bënë më të mundur përmbushjen e këtyre parimeve.

Është bërë e zakonshme të krahasohet Bashkimi Evropian me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe të konkludohet se Evropa është larg nga arritja e integritetit që është arritur përtej Atlantikut. Poashtu, dikush mund të shtron edhe pyetjen: Se si do funksionin sot Shtetet e Bashkuara të Amerikës sikur të kishin mbetur në përdorim monedhat e ndryshme që përdornin shtetet e SHBA në shekullin e 19.

Duke përmbledhur, mund të nxjerrim dy konstatime. Së pari, se Bashkimi Evropian nuk përbënë një hapësirë monetare plotësisht optimale. Ajo ka përmbushur në nivel të kënaqshëm disa parime, por ka dështuar të përmbush disa parime të tjera. Së dyti, nuk është e pamjaftueshme vetëm lëvizja e lirë e fuqisë punëtore, por në përgjithësi, tregjet e punës shfaqin ngurtësi të konsiderueshme. Për pasojë, unioni monetar mund të përkeqësojë edhe ashtu një situatë të dhimbshme të papunsisë së lartë, të paktën në disa nga vendet anëtare.

Prandaj është e natyrshme të shtrohet pyetja: pse drejtuesit e vendeve dhe qeverive Evropiane të tubuar në Maastricht në vitin 1991, kishin vendosur të merrnin riskun duke formuar unionin monetar. Përgjigja është: politika. Forca themelore shtytëse që kishte shtyrë përpara procesin e integriteteve evropiane që nga vitet e 1940ta ishte besimi se, luftërave që po zgjasnin për më tepër se 1000 vite duhej t'iu vinte fundi, dhe se, zgjidhja më e mirë për të ardhmën do ishte integriteti i thellë ekonomik. Kur Evropa të arrijë fazën e gërshetimit të interesave ekonomike të vendeve anëtare, atëherë më nuk do ekzistonte motivi për konkurrencë tjetër përveç asaj në tregje, për të mirën e të gjithëve. Dhe realisht, në çdo hap drejtë bashkimit, kur negociatat ishin të vështira, liderët politik gjithnjë bënin lëshime të nevojshme për të arritur marrëveshje të caktuara, madje shpesh jo plotësisht të kënaqshme, dhe ate gjithnjë me arsyetimin se po kontribuonin për forcimin e paqës në kontinent. Në këtë kuptim, Evropianët e ndjejnë si fatë të përbashkët unionin monetar.

Konkluzione

1. Paraja është më e vlefshme sa më tepër njerëz që e përdorin atë. Mbi këtë bazë, bota do duhej të përdorte një monedhë të përbashkët. Mirëpo, përdorimi i monedhës së përbashkët mbart kosto të caktuara. Teoria e hapësirës monetare optimale balancon dobitë dhe kostot e përdorimit të monedhës së përbashkët.
2. Nëse çmimet dhe pagat janë fleksible, kursi i këmbimit ndihmon në zgjidhjen e situatave kur paraqiten tronditje asimetrike. Në unionin monetar janë me rëndësi tronditjet asimetrike të vendeve anëtare.
3. Teoria e hapësirës monetare optimale shtron çështjen se cilat karakteristika të unionit monetar ndikojnë në paraqitjen e tronditjeve asimetrike. Ajo më pas zhvillon parimet, të cilat nëse përmbushën, i bëjnë humbjet nga kursi i këmbimit më pak të dhimbshme.
4. Tri parime ekonomike klasike të teorisë së hapësirës monetare optimale janë: Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore; Shumëllojshmëria e prodhimit; dhe Hapja e ekonomisë kombëtare. Tri parime politike të teorisë së hapësirës monetare optimale janë: Transferët fiskal; Homogjeniteti i preferencave; dhe Solidariteti mes vendeve anëtare të unionit monetar.
5. Unioni Monetar Evropian ka përmbushur tri parime të teorisë së hapësirës monetare optimale: Hapja e ekonomisë kombëtare, Shumëllojshmëria e prodhimit, dhe Homogjeniteti i preferencave. Por nuk ka përmbushur parimet tjera, siç janë: Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore, Transferët fiskal, kurse parimi Solidariteti mes vendeve anëtare të unionit monetar, me gjasë është përmbushur.
6. Ekzistojnë arsye për të besuar se niveli i përmbushjes së parimeve të teorisë së hapësirës monetare optimale është me karakter endogjen: duke qenë brenda unionit monetar e bënë më të mundur përmbushjen e këtyre parimeve.
7. Në fund duhet theksuar se, vendimi për të formuar një union monetar nuk është i lehtë, nuk është bardhë e zi. Ai përfshinë risqet dhe mund të kërkojë masa të tjera bashkërenduese. Kjo është rasti edhe me Unionin Monetar Evropian.

Referenca

1. Abed, G. T., Erbas, S. N, Guerami, B., "The GCC Monetary Union: Some considerations for the Exchange Rate Regime," IMF Working Paper, No 66. 2003.
2. Baldwin, Richard and Charles Wyplosz, The Economics of European Integration, McGraw-Hill. 2004.
3. Bayoumi, T. and Eichengreen, B., "Monetary and Exchange Rate Arrangements for NAFTA," Journal of Development Economics, 43, pp. 125-165. 1994.

4. Corsetti, P., and Pesenti, P., "Self-Validating Optimum Currency Areas," NBER Working Paper No. 8783, pp. 1-24. 2002.
5. De Grauwe, P., *The Economies of Monetary Integration*, Fifth Edition. Oxford. 2003.
6. De Grauwe, P. and Mongelli, F., "Endogeneities of Optimum currency Area: What Brings Countries Sharing a Single Currency Closer Together"? ECB Working Paper No. 468. 2005.
7. Eijffinger C.W. Sylvester and Jakob De Haan, *European Monetary and Fiscal Policy*, Oxford. 2000.
8. Fasano-Filho, U., and Schaechter, A., "Monetary Union among the Member Countries of the Gulf cooperation Council," IMF Occasional Paper, International Monetary Fund, Washington D.C. 2003.
9. Frankel, J., and Rose, A., "Is EMU More Justifiable EX Post than EX Ante?" *European Economic Review*, 41, pp735-760. 1997.
10. Frankel, J., and Rose, A., "The Endogeneity of the Optimum Currency Area Criteria," *Economic Journal*, 108, pp. 1009-1025. 1998.
11. Frankel, J., "Verifiability and the Vanishing Intermediate Exchange Rate Regime," NBER Working Paper No. 7901. 2002.
12. Frankel, J., "Proposed Monetary Regime for Small Commodity-Exporters: Peg the Export," Kennedy School of Government, January, RWP No. 03-003. 2003a.
13. Frankel, J., "Experience of and Lessons from Exchange Rate Regimes in Emerging Economies," NBER Working Paper No. 10032. 2003b.
14. Gudmundsson, M., "The Role of the Effective Exchange Rate in Monetary Frameworks: The International Experience," BIS Working Paper. 2005.
15. Hammoudeh, S., and Aleisa, E., "The dynamic linkage of the GCC Stock Markets," *Contemporary Economic Policy*, January, 22(1) pp 50-62. 2004.
16. Hansen, Drud Jorgen, *European Integration: An Economic Perspective*, Oxford. 2002.
17. Jadresic, E., "On a Currency for the GCC Countries," IMF Policy Discussion Paper (PDP/02/12), International Monetary Fund, Washington, D.C. 2002.
18. Kenen, P., "The Theory of Optimum Currency Areas: An Eclectic View." In: Mundel, R.A, Swooboda, A. K., ed., *Monetary Problems in the International Economy*, University of Chicago Press, Chicago. 1969.
19. McKinnon, R., "Optimum Currency Area," *American Economic Review*, (September), pp. 717-725. 1963.
20. Mongelli, Francesco Paolo, "European economic and monetary integration and the optimum currency area theory", EUROPEAN COMMISSION, Economic Papers 302, February 2008.

21. Moudell, R., "The Theory of Optimum Currency Area," American Economic Review, 51(4), pp. 657-665. 1961.
22. Nello, Senior Susan, The European Union: Economics, Policies and History, McGraw-Hill. 2005.

